



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

01 Nr. MA/02-29802  
Më: 21.06.2024

Komuna e Lipjanit bazuar në nenin 16 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dhe në mbështetje të neneve të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, dhe neneve 40 e 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 shpall konkurs për praktikantë me pagesë:

### KONKURS PËR PRAKTIKANTË

- **Titulli i vendit të Punës: Praktikant/ë - 30 ( tridhjetë pozita ) nga drejtimet e cekura:**
  1. Fakulteti: Arkitekt, Inxhinier i Ndërtimtarisë, Hidros, Inxhinier i Elektros, Komunikacionit.
  2. Fakulteti Juridik, Administratë Publike, Pedagogji, Psikologji, Ekonomik, Fakulteti i Bujqësisë, Sociologjisë, Infermierisë dhe Gjuhë Angleze.
- Orari i plotë 40 orë në javë
- Kohëzgjatja e praktikës: 5 (pesë) muaj.
- Pagesa: 350 € ( treqind pesë dhjetë euro) në muaj.
- Dokumentet e kërkuara:
  - Diploma Universitare, si dhe vërtetimin që dëshmon se janë duke i vijuar studimet universitare në drejtimet e fakultetit sipas pikës 1 .
  - Dokumenti i identifikimit

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të ketë njohuri të përgjithshme
- Të ketë aftësi komunikimi;
- Të ketë aftësi në organizimin e punës dhe në kryerjen e detyrave të punës.
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Praktika profesionale synon përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit.

Aplikantët e suksesshëm do të sistemohen në Administratën e Komunës së Lipjanit dhe do të angazhohen të kryejnë detyrat e përgjithshme nëpër Drejtorate dhe sektorë për kryerjen e punëve profesionale. Pagesa e praktikantëve do të bëhet nga kategoria ekonomike-subvencionet e planifikuara për vitin 2024.

Data e mbylljes së konkursit 8 ditë nga shpallja në mjetet e informimit publik.

Formularët e kërkesave janë në dispozicionin tuaj dhe mund t'i merrni në Qendrën për Shërbime me Qytetar në Komunë në sportelin Nr. 3 dhe po aty bëhet dorëzimi i aplikacioneve.

Kërkesat e arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen. Kërkesat e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

*"Të drejte aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme shkollore dhe aftësi fizike që kërkohet për pozitën përkatëse"*

IMRI AHMETI  
KRYETAR I KOMUNËS

